



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2019

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për “**Blerimi**” sh.p.k me adresë: fshati Mjekës, Njësia Administrative Shirgjan, rruga Elbasan-Cerrik km 4, Elbasan

Procedura e prokurimit: “**Proçedurë e Hapur**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 16355-04-02-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Asfaltim i rrugës së varrezave në Kuqan, Njësia Administrative Shirgjan**” me fond limit: **12,286,294** (dymbëdhjetëmilion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë për vitin 2019, dhe me afat për kryerjen e punimeve **2 (dy) muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në proçedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Blerimi” sh.p.k me Nipt: J 62903384 G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8,498,602** (tetëmilion e katërqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e dy) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **10,198,322** (dhjetëmilion e njëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e treqind e njëzet e dy) **lekë** (me tvsh).

2. “Avduli” sh.p.k me Nipt: J 66703306 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **9,812,622** (nëntë milion e tetëqind e dymbëdhjetëmijë e gjashtëqind e njëzet e dy) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **11,775,146** (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e njëqind e dyzet e gjashtë) **lekë** (me tvsh).

3. “B-93” sh.p.k me Nipt: J 62903508 R

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10,127,643** (dhjetë milion e njëqind e njëzet e shtatëmijë e gjashtëqind e dyzet e tre) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **12,153,172** (dymbëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e tremijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë** (me tvsh).

4. “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10,372,137** (dhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e dymijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **12,446,564** (dymbëdhjetë milion e katërqind e dyzet e gjashtëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër) **lekë** (me tvsh).

5. “Vëllezërit Hysa” sh.p.k. me Nipt: K 12911201 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **11,569,435** (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntëmijë e katërqind e tridhjetë e pesë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **13,883,322** (trembëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tremijë e treqind e njëzet e dy) **lekë** (me tvsh).

6. “Sireta 2F” sh.p.k me Nipt: K 51501008 J

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **11,666,666** (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **13,999,999** (trembëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) **lekë** (me tvsh).

7. “Nika” sh.p.k me Nipt: J 76705047 U

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8,482,045** (tetë milion e katërqind e tetëdhjetë e dymijë e dyzet e pesë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **10,178,454** (dhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) **lekë** (me tvsh).

8. “K.M.K” sh.p.k me Nipt: L 78223801 E

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8,926,243** (tetëmilion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e dyzet e tre) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **10,711,492** (dhjetë milion e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë** (me tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k me Nipt: J 76705047 U

2. Operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k me Nipt: L 78223801 E

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k skualifikohet për arsye se :

a) nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST pika 2.3.5 të kapacitetit teknik ku thuhet : Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi profili transport ...

Inxhinieria Gentiana Mosko, e paraqitur nga OE si inxhinierë ndërtimi profili transport, bazuar në Diplomën dhe Licensën e projektimit si dhe listëpagesat e shoqërisë (kodi 2142.29) të ngarkuara në SPE rezulton të jetë inxhinierë ndërtimi, profili ndërtime civile industriale ura dhe jo i profilit të kërkuar në DST (profili transport).

b) nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST pika 2.3.7 të kapacitetit teknik ku thuhet : Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si mëposhtë:

- 1 (një) punonjës hidraulik ...

Ardit Mija është deklaruar si hidraulik por bazuar në listepagesat e shoqërisë “NIKA” të paraqitura në SPE për muajin e fundit si dhe bazuar në VKM nr 514, datë 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Ardit Mija i deklaruar si hidraulik, me kod 9313.01 figuron të jetë punëtor krahu në ndërtim godinash.

Fatos Mija, Blerjan Shuri dhe Orion Shuri janë deklaruar nga shoqëria si hidraulik por asnjëri prej tyre nuk figuron në listepagesat e shoqërisë “NIKA” për muajin e fundit.

c) nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST pika 2.3.9 të kapacitetit teknik - Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës- ku ndër të tjera kërkohet:Për secilin prej mjeteve të paraqiten fotografi të tyre.

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur foto për makinën e vijëzimit.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]”

“Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

2. Operatori ekonomik “K.M.K” sh.p.k skualifikohet për arsye se :

a) nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST pika 2.3.1 të kapacitetit teknik ku thuhet: Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a- Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 6,143,147 (gjashtëmilion e njëqind e dyzet e tremijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekë pa t.v.sh., të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit;

OSE

b- Punë të ngjashme ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, është një vlerë jo më e ulët se 24,572,588 (njetzet e katermilion e peseqind e shtatedhjetë e dymije e peseqind e tetëdhjetë e tete) lekë pa t.v.sh..

Operatori ekonomik “K.M.K” ka deklaruar gjithsej 6 (gjashtë) kontrata të punëve të ngjashme. Në secilë prej tyre vlera për një objekt të vetëm është më e ulët se ajo e kërkuar në DST. Gjithashtu vlera totale e punëve të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, për të gjashta kontratat e paraqitura është 9,661,737 (nëntëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa tvsh., pra operatori nuk e përmbush këtë pikë të kriterit të veçantë të kualifikimit, ku vlera totale e punëve të ngjashme

duhet të ishte 24,572,588 (njëzet e katërmilion e pesëqind e shtatëdhjetë e dymijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh.

b) nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST pika 2.3.3 të kapacitetit teknik ku thuhet: Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat e tjera, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

b) Diplomë

Operatori ekonomik “K.M.K” nuk ka paraqitur asnjë deklaratë në lidhje me Drejtuesin Teknik të punimeve.

c) nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST pika 2.3.7 të kapacitetit teknik ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si mëposhtë:

- 1 (një) punonjës hidraulik ...

Irildi Disha është deklaruar si hidraulik por bazuar në listepagesat e shoqërisë “K.M.K” të paraqitura në SPE për muajin e fundit si dhe bazuar në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Irildi Disha i deklaruar si hidraulik, me kod 9312.06 figuron të jetë punëtor krahu në ndërtim.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

“Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë

ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Blerimi”** sh.p.k me adresë: fshati Mjekës, Njësia Administrative Shirgjan, rruga Elbasan-Cerrik km 4, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **8,498,602** (tetëmilion e katërqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e dy) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pese) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anulojë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 05.06.2019

Ankesa nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari
Vesa Liço**